



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

## MEMORANDUM SHPJEGUES

### PËR

## PROJEKT RREGULLORES NR. X/2023 PËR PËRDORIMIN E SISTEMIT PËR MENAXHIMIN INFORMATIV TË LËNDËVE

#### 1. Qëllimi i hartimit të aktit normative

Kjo projekt rregullore ka për qëllim të përcaktoj parimet, rregullat, rolin, detyrat dhe qasjen e gjyqtarëve, stafit administrativ në gjykata dhe në Këshill në përdorimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve.

Përmes kësaj draft rregullore përcaktohen rregullat për krijimin e llogarive për përdoruesit, pranimin, regjistrimin dhe shpërndarjen e lëndëve, krijimin e folderit përkatës për lëndën, si dhe mënyrën dhe formën e mbylljes së folderit në gjykatat përkatëse.

Me tej, projekt rregullorja përcakton krijimin dhe zgjidhjen e folderit të lëndës në gjykatë nga faza e ngritjes së aktit akuzues deri në plotfuqishmërinë e vendimit për lëndët

	<p>penale, civile dhe për lëndët për kundërvajtje, krijimin dhe zgjidhjen e folderit lidhur me kërkesat për urdhër ndëshkimor, si dhe regjistrimin e mjeteve të jashtëzakonshme juridike.</p> <p>Tutje, projekt rregullorja përcakton edhe mënyrën e krijimit të folderit në lëndët përmbartimore dhe për lëndët kthyer në rigjykim, si dhe delegimin e lëndëve në një gjykatë tjetër.</p>
<p>2. Arsyetimi i aktit normative</p>	<p>Arsyeja e hartimit të projekt Rregullores Nr. XX/2023 për Përdorimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve qëndron në atë, sepse me fillimin e implementimit dhe zbatimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (tutje: SMIL) në gjykatat e Republikës së Kosovës sipas Rregullores Nr. 08/2019 aktualisht në fuqi, është vërejtur se ka nevojë për ndryshime.</p> <p>Iniciativa për përmirësimin dhe lehtësimin e përdorimit të SMIL gjatë punës së përditshme në Gjykata i ka paraprirë edhe synimit për të hartuar këtë projekt rregullor.</p> <p>Gjatë përdorimit të SMIL në gjykata, ka lind nevoja që ky sistem të avancohet dhe të ndryshohet në baze të kërkesave dhe nevojave të përdoruesve, dhe si rrjedhojë e kësaj është parë e nevojshme që stafi administrativ të kryej detyrat e caktuara nga</p>

	<p>gjqtare me qëllim të lehtësimit të punës së gjyqtarëve.</p> <p>Tutje, të gjitha ndryshimet e parapara si të nevojshme janë përcaktuar në këtë projekt rregullore përmes së cilës përcaktohen roli, detyrat dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve dhe stafit administrativ, përfshirë bashkëpunëtorët profesional, zyrtarët ligjore dhe përkthyesit në përdorimin e SMIL-it.</p>
<p>3. Kohëzgjatja e konsultimit publik</p>	<p>Përmes procesit të konsultimeve me publikun, synohet transparenca dhe ofrohet mundësia e pjesëmarrjes së publikut dhe palëve të interesuara në procesin e hartimit të Draftit të Rregullores Nr.X/2023 për Përdorimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve.</p> <p>Këshilli fton të gjithë profesionistët e interesuar që të paraqesin komentet apo sugjerimet e tyre, për përmirësimin e draftit të kësaj rregullore.</p> <p><b>Kohëzgjatja e konsultimit publik është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike, përkatësisht deri me 6 tetor 2023.</b></p>
<p>4. Informatat në lidhje me personin kontaktues për konsultim publik</p>	<p>Të gjithë pjesëmarrësit e publikut dhe palët e interesuara mund t'i japin komentet dhe sugjerimet e tyre brenda afatit të përcaktuar për konsultim publik për këtë draft</p>

rregullore, përmes postës elektronike në këtë  
e-mail adresë: [kgjk@rks-gov.net](mailto:kgjk@rks-gov.net)